

VENDIM
Nr.153, datë 03.03.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.954, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR ORGANIZIMIN, STRUKTURËN, FUNKSIONIMIN E QENDRËS
NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE (QNOD) DHE
BASHKËVEPRIMIN ME INSTITUCIONET SHTETËRORE, QË KANË INTERESA NË
DET", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të neneve 3, pika 3, e 4/1, pika 3, të ligjit nr.8875, datë 4.4.2002, "Për Rojën Bregdetare Shqiptare", të ndryshuar, të neneve 6, 29, e 41 të ligjit nr.9861, datë 24.1.2008 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shtojca nr.1, që përmendet në pikën 1 të kreut III të vendimit nr.954, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të jetë sipas shtojcës me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA E QNOD

